



RREGULLORE PËR ORGANIZIMIN E GARAVE, REGJISTRIMIN E KLUBEVE DHE ANËTARËVE TË FSHK-së

Neni 1

Qëllimi i kësaj rregullore është të precizoj detajet e organizimit të garave nga Federata e Shahut në Republikën e Kosovës.

Neni 2

Organizimet e garave ndahen në:

1. Organizimet e Federatës së Shahut të Kosovës (FSHK), dhe
2. Organizimet e subjekteve të ndryshme në bashkëpunim me Federatën e Shahut. Këtu përfshihen organizimet e Klubeve, Komunave, Qeverisë, OJQ, etj.

Neni 3

Klubet e shahut dhe shahistët për t'u bërë anëtarë me të drejta të plota duhet më parë të regjistrohen në Federatën e Shahut të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Federatë).

Neni 4

Shahisti/tja mund të regjistrohet për secilin klub të shahut, sipas zgjedhjes ose dëshirës së tij/saj. Çdo shahist mund të regjistrohet vetëm për një klub shahu në Kosovë, përveç shahistëve të hendikepuar (shurdhmemecë, të verbër etj.), të cilët mund të jenë njëkohësisht edhe anëtarë të klubit të shahut të hendikepuarve, të verbërve, shurdhmemecëve apo formave tjera organizative brenda ombrellës së Federatës.

Neni 5

Shahisti që më parë nuk ka qenë anëtar i asnjë klubi, duhet të paraqes kërkesën për anëtarësim në klubin që dëshiron të regjistrohet. Kërkesa përmban këto shënime:

- Emrin, emri i babës, mbiemri;
- Data dhe vendi i lindjes;
- Profesioni;
- Adresa e banimit si dhe
- Deklaratën nën betim se nuk është anëtar i asnjë klubi tjetër shahu.

Neni 6

Vetëm klubet dhe anëtarët (shahistët) e regjistruar mund të marrin pjesë në garat kampionale të cilat i organizon Federata dhe në bazë të Rregullorës për kategorizim të fitojnë kategori ose tituj, si dhe mund të luajnë për klubin dhe qytetin e tyre, ose për përfaqësuesen e Kosovës.

Neni 7

Për t'u regjistruar një klub, ai duhet t'i paraqes Federatës këto dokumente:

- a) kërkesën për regjistrim si dhe emrin dhe adresën e klubit;
- b) deklaratën me shkrim të aplikuesit për zbatimin dhe respektimin e Statutit dhe akteve tjera juridike të FSHK-së;
- c) certifikatën e OJQ-së nga Ministria e Administratës Publike dhe vërtetimi nga Drejtoria Komunale për Sport;
- d) një kopje të statutit dhe rregulloreve të saj, të cilat duhet të jenë në pajtim me ligjin për sport dhe statutin e FSHK-s;
- e) ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja themeluese e klubit ose nga kuvendi zgjedhor;
- f) emërat e personave të autorizuar për përfaqësim;
- g) listën e anëtarëve të kryesisë, kryetarit dhe sekretarit të klubit;
- h) listën e anëtarëve të klubit, i cili duhet të ketë më së paku **12** anëtarë dhe shënimet për ta, sipas nenit 3(tre), të kësaj Rregulloreje;
- i) të përmbushë detyrimet financiare që i përcakton Federata;

Neni 8

Çdo shahist duhet të paguaj antarësin vjetore në vlerë prej 5.00 €. Shahistët e klubeve pagesën e bëjnë nëpërmjet klubeve, kurse shahistët që nuk kanë klube pagesën e bëjnë në mënyrë direkte.

Neni 9

Organizimet e garave të FSHK-së janë të gjitha garat që i organizon FSHK-së. Pjesëmarrësit në këto gara duhet të bëjnë pagesat e kotizimit si në vijim:

- Kupa Individuale e Kosoves: -----	5.00 €
- Liga e Parë e Kosovës –Meshkujt: -----	200.00 €
- Liga e Dytë e Kosovës- Meshkujt: -----	100.00 €
- Liga e pare e Kosoves- Femrat: -----	0.00 €
- Kampionati individual i Kosovës për junior: -----	0.00 €
- Kampionati Individual i Kosovës- Meshkujt: -----	5.00 €
- Kampionati Individual I Kosovës: -----	0.00 €
- Kupa Ekipore e Kosovës: -----	50.00 €
- Kotizimi për shahistet e huaj me ELO mbi 2300: -----	0.00 €
- Kotizimi për shahistet e huaj me ELO perfundi 2300: -----	100.00 €

Neni 10

Të gjitha subjektet që organizojnë gara të shahut e që duan të shfrytëzojnë infrastrukturen e FSHK-së duhet që të bëjnë kontratë me FSHK-në së paku një javë para mbajtjen së garës dhe të paguajnë shumën sipas shpenzimeve të specifikuara:

- Infrastruktura e FSHK-së përfshin:
Tabelat, orët e shahut, laptopin, transportin-----100.00 €
- Referët:-----50.00 €
- Ushqimi dhe shpenzimet tjera:-----50.00 €

Pagesa bëhet me parapagim në xhironlogarin e FSHK-së të specifikuar nga ana e saj.

Neni 11

Të gjitha garat e organizuar nga FSHK-së ose nga subjektet tjera në bashkpunim me FSHK-në duhet të referohen nga refer që i cakton FSHK-së në mënyrë rotative. Varësisht nga niveli organizimit, turniret mund ti referojnë edhe 2 (dy) e më shumë referë. Pagesa për refer duhet të jetë 50.00 €.

Neni 12

Shahistët dhe Selektori me ndihmësit e tij që marrin pjesë në Olimpiadën e Shahut duhet të paguhet me mëditje në vlerë 30.00 €. Kjo shumë mund të rritet varësisht nga suksesi dhe gjendja financiare e FSHK-së.

Neni 13

Regjistrimi i klubeve dhe i shahistëve bëhet bazuar në planin vjetor i cili përgaditet nga kryesia e FSHK-së në çdo fillim vitë kalendarik.

Kryesia e FSHK-së për çdo sezonë duke ju referuar planit vjetor të aktiviteteve i informon klubet për periudhën e regjistrimit dhe të afatit kalimtarë të shahistëve për vitin vijues.

Neni 14

Klubi nuk është më anëtar i Federatës në rastet:

- a) kur shpërbëhet (rasformohet);
- b) kur nuk e përtrinë regjistrimin në afatin e përcaktuar;
- c) në raste kur i shqiptohet masa ndëshkuese e përjashtimit nga FSHK-ja.

Neni 15

Në rastet e bashkimit të 2 (dy) ose më shumë klubeve në një klub, të gjithë anëtarët e regjistruar të atyre klubeve, mbajnë në atë klub të gjitha të drejtat dhe detyrimet që i kanë pasur deri më rastin e bashkimit.

Klubi i bashkuar ka të drejtë të marrë pjesë vetëm në rang më të lartë; në rastet kur ato kanë bërë gara në rang të ndryshëm.

Bashkimi i klubeve konsiderohet i plotëfuqishëm nëse vendimi është marrë në mbledhje të përbashkët të atyre klubeve si dhe është regjistruar pranë organeve shtetërore.

Neni 16

Klubi është i detyruar që t'i japë fletëçregjistrimin secilit anëtar të vet në afat prej 10 ditësh nga data e paraqitjes së kërkesës të anëtarit me shkrim, ose në atë afat t'i lëshojë vendimin për refuzimin e kërkesës. Në këto 2 (dy) raste, klubi është i detyruar që ta lajmërojë Federatën, duke i dërguar fletëçregjistrimin, ose vendimin për refuzim të asaj kërkesë.

Gjatë paraqitjes së kërkesës për fletëçregjistrim, klubi është i detyruar t'i lëshojë vërtetim për pranimin e kërkesës.

Neni 17

Fletëçregjistrimi duhet të përmbajë:

- a) Emri i klubit që e lëshon atë dhe data e lëshimit të fletëçregjistrimit;
- b) Emri e mbiemri i shahistit që i lëshohet fletëçregjistrimi;
- c) Kategoria ose titulli që ka dhe kur e ka arritur atë.

Fletëçregjistrimi bëhet në tri kopje të cilat i ipen:

- Paraqitësit të kërkesës;
- Federatës dhe klubit;

Neni 18

Në rastet kur klubi nuk vepron sipas dispozitave të kësaj rregulloreje, Federata shahistin e konsideron të ç'regjistruar pasi të ketë vërtetuar se ai e ka kërkuar fletëregjistrimin sipas kësaj Rregulloreje.

Neni 19

Klubet e shahut kanë të drejtë të regjistrojnë edhe shahistë jashtë Kosovës, por në një ndeshje nuk kanë të drejtë të luajnë më shumë se një (1) shahistë të jashtëm (nuk konsiderohen të jashtëm shahistët kosovarë që jetojnë, punojnë dhe luajnë shah në diasporë). Për çdo shahistë të jashtëm në regjistrim, klubi është i detyruar që FSHK-së t'i paguaj shumën sipas nenit 9.

Neni 20

Anëtari që regjistrohet për herë të parë, ka të drejtë loje në të gjitha garat prej ditës së regjistrimit.

Neni 21

Secili shahist i regjistruar duhet të posedojë librezën e anëtarësisë (të vërtetuar) të cilën e lëshon Federata.

Neni 22

Libreza e anëtarësisë duhet gjithsesi të përmbajë:

- a) Fotografinë e shahistit (formati 2,5 x 3,5 cm), ose në formë elektronike;
- b) Shënimet personale (emri, emri i babës dhe mbiemri, dita, muaji dhe viti i lindjes, vendlindja dhe profesioni);
- c) Emri dhe selia e klubit për të cilin regjistrohet;
- ç) Data e regjistrimit;
- d) Shënimi mbi kategorinë ose titullin dhe viti i arritjes;
- e) Rubrika me shënime për ndërrimin e klubit;
- ë) Rubrika për ç'kohë vlen libreza.

Neni 23

Komisioni për regjistrim është i detyruar që të mbajë evidence të saktë për të gjitha klubet dhe anëtarët e regjistruar në Federatë dhe të raportoj në baza të rregullta.

Kjo rregullore është miratuar në Kryesinë e Federatës të mbajtur më datën: 20.04.2022 (on-line)

Kryesia e FSHK-së:

Kryetari: Armend Budima

Nenkryetari: Nazmi Selmanaj

Anëtarë: Fehim Qorrolli

Anëtarë: Albert Ajroni

Anëtarë: Valmor Bardhi

Anëtarë: Fatmir Gerguri

Anëtarë: Besnik Berisha

Anëtarë: Mahije Ismajli

Anëtarë: Emell Dili

Anëtarë: Nita Saraçi